

Vendim nr. 237 datë 24.09.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 24.09.2025 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 2 (O) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ORANDO MULLETI**, përfaqësuar nga avokat Redi Xhelepi, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-4569, datë 13.11.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

BAZA LIGJORE: **Nenet 11, pika 2, 41, pika 1, 42, pika 1 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); nenet 6 dhe 13 Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Orando Mulleti, përmes kontratës noteriale të shitblerjes së datës 13.04.2012, është bërë pronar i një trualli me sipërfaqe 400 m², të ndodhur në Tiranë. Me pretendimin se trualli posedohej në mënyrë të paligjshme nga shtetasit K.P. dhe Q.P., të cilët mbi të kanë ndërtuar një objekt pa lejen e organeve kompetente shtetërore, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me një padi rivendikimi, sipas nenit 296 të Kodit Civil (KC), duke kërkuar detyrimin e tyre për t'i liruar dhe dorëzuar sipërfaqen e truallit të zënë prej 336 m².

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9650, datë 30.09.2013, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesit, duke arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, se është ngritur ndaj personave që nuk janë posedues të paligjshëm të pronës. Ky vendim është lënë në fuqi, në vijim, pas ankimit të kërkuesit, nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 30-2014-7030, datë 18.11.2014. Ndërkohë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-4569, datë 13.11.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), sipas përmbajtjes së tij në kohën e paraqitjes së rekursit.

3. Në datën 19.06.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 30.06.2025.

II

Pretendimet e kërkuesit

4. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

4.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

4.1.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim provën e re të paraqitur me shtesën e rekursit të datës 11.10.2021, konkretisht shkresën nr. 5431, datë 01.06.2021 të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), sipas së cilës objekti informal i të paditurve bën pjesë në njësinë strukturore TR/80-PVD, e cila referuar planit të

përgjithshëm vendor të Bashkisë së Tiranës, të miratuar me vendimin nr. 1, datë 14.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit, parashikon ndërtime 7-katëshe. Në këto kushte, objekti pa leje i të paditurve ndodhet në kushtet e nenit 29, pika 1, të ligjit nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare në Republikën e Shqipërisë” dhe ai nuk mund të legalizohet.

- 4.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i gjykatës së shkallës së parë është kontradiktor, duke legjitimuar të paditurit si posedues të ligjshëm të pronës vetëm sepse kanë plotësuar formularin për legalizimin e banesës, duke zhveshur kështu pronarin e ligjshëm nga pronësia në favor të poseduesve të paligjshëm pa asnjë bazë ligjore. Ajo gjykatë ka konfunduar kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore sikur ajo të ishte në pronësi të shtetit dhe jo vetëm kaq, por arrin në konkluzionin se vetëm nëse organi administrativ shprehet për moslegalizimin e objektit, kërkuuesi mund t’i drejtohet gjykatës me padinë e rivendikimit. Edhe gjykata e apelit, me të njëjtin arsyetim si ai i shkallës së parë, ka legjitimuar paligjshmërinë e posedimit të palës së paditur, megjithëse sipas shkresës nr. 2720/1 prot, datë 13.03.2013 të Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), procedura e legalizimit për të paditurit është pezulluar.
- 4.1.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi vendimet e gjykatave të zakonshme vijnë në kundërshtim me vendime të gjykatave të faktit dhe të Gjykatës së Lartë në raste të ngjashme.
- 4.2. *E drejta e pronës private*, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë mohuar kërkuetit të drejtën e pronës, të garantuar nga Kushtetuta dhe aktet ndërkombëtare.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuetit

5. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin

përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

6. Kolegji vlerëson se kërkuksi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

7. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, rezulton se kërkuksi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

8. Kolegji çmon se kërkuksi legjitimohet *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, referuar shkresës nr. 2470/1 prot, datë 19.05.2025 të kësaj gjykate, është bërë i disponueshëm për palët në datën 20.02.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 19.06.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

9. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuksi ka pretenduar se vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të *së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe parimit të sigurisë juridike*, si dhe të drejtën e pronës private, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin e kësaj Gjykate.

10. Në drejtim të *së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, kërkuksi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim provën e re të paraqitur nga ai me shtesën e rekursit. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një

interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë të vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë ose të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar gjatë gjykimit në fakt (*shih vendimet nr. 15, datë 23.03.2023; nr. 10, datë 03.04.2018; nr. 20, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, si dhe duke pasur parasysh se, sipas nenit 141, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata e Lartë ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta, ndërsa vlerësimi i provave nuk është kompetencë e saj, në rastin konkret Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit se Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh provën e re të depozituar me shtesën e rekursit, nuk mund të merret në shqyrtim.

11. Në ankimin kushtetues individual kërkuar ka pretenduar cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, me argumentin se vendimet e gjykatave të zakonshme vijnë në kundërshtim me vendime të gjykatave të faktit dhe të Gjykatës së Lartë në raste të ngjashme. Kolegji vëren se në materialet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual kërkuar nuk ka paraqitur ndonjë nga praktikat gjyqësore, për të cilat pretendon se nuk janë marrë parasysh nga gjykatat e zakonshme në rastin në shqyrtim. Për më tepër, në jurisprudentën e saj Gjykata ka theksuar se ekzistenca e dy vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë, ku ajo është shprehur në mënyrë të ndryshme për zbatimin e ligjit, nuk passjell pritshmëri të ligjshme të kërkuarit për zbatimin e tij, në kushtet kur nuk është kryer një interpretim unifikues ose njësores në lidhje me të (*shih vendimin nr. 4, datë 31.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të sigurisë juridike nuk mund të merret në shqyrtim.

12. Për sa u përket pretendimeve të tjera, duke mbajtur në konsideratë se argumentet mbi të cilat kërkuar ka bazuar pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës janë të ndërrarura me ato për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, Kolegji çmon që çështja të analizohet në vijim në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona private nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës private, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Po kështu, duke mbajtur në konsideratë se kërkuar parashtron si shkak për cenimin e së drejtës kushtetuese të pronës interpretimin që gjykatat e zakonshme u kanë bërë dispozitave të KC-së lidhur me padinë e rivendikimit dhe ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” (*ligji nr.*

9482/2006), Kolegji çmon që pretendimet e kërkuarit të analizohen në vijim në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës.

B. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës

13. Kërkuari ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara janë kontradiktore, pasi kanë legjitimuar të paditurit si posedues të ligjshëm të pronës vetëm sepse kanë plotësuar formularin për legalizimin e banesës, duke zhveshur kështu pronarin e ligjshëm nga pronësia në favor të poseduesve të paligjshëm pa asnjë bazë ligjore. Po sipas tij, gjykatat kanë konfunduar kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore sikur ajo të ishte në pronësi të shtetit dhe jo vetëm kaq, si dhe kanë arritur në konkluzionin se vetëm nëse organi administrativ shprehet për moslegalizimin e objektit, kërkuari mund t'i drejtohet gjykatës me padinë e rivendikimit, megjithëse sipas shkresës nr. 2720/1 prot, datë 13.03.2013 të ALUIZNI-it procedura e legalizimit për të paditurit është pezulluar.

14. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 33, datë 30.05.2023; nr. 11, datë 10.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata ka theksuar se garantimi i së drejtës së pronës përbën një ndër aspektet më thelbësore të shoqërisë demokratike. Sipas nenit 41 të Kushtetutës, e drejta e pronës private është e garantuar dhe askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik. E drejta e pronës, si e drejtë universale e njeriut, përfshin çdo posedim të sendeve ose të të drejtave të tjera materiale pasurore dhe në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i kësaj të drejte. Në çdo rast, kjo e drejtë shtrihet ndaj sendeve, pronësia e të cilave është fituar në përputhje me ligjin (*shih vendimet nr. 36 datë 21.04.2017; nr. 25, datë 28.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, me gjithë mbrojtjen që ajo gëzon, e drejta e pronës mund t'u nënshtrohet kufizimeve, të cilat duhen bërë sipas disa kritereve të përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 17 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 15, datë 22.06.2022; nr. 25, datë 28.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjithashtu, Gjykata ka kontrolluar kushtetutshmërinë e ligjit nr. 9482/2006 në lidhje me pretendimet për kufizimin e së drejtës së pronës private, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, duke arritur në përfundimin se ky ligj kufizon të drejtën e pronës private, pasi megjithëse nuk përmend termin “shpronësim” dhe nuk siguron një procedurë formale shpronësimi, fakti se në bazë të nenit 15 të ligjit personat e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme dhe që kompensohen për shkak të regjistrimit të zotëruesve të ndërtesave të paligjshme do të quhen *de facto* dhe *de jure* të shpronësuar. Megjithatë, ekziston një interes publik që mund të justifikojë shpronësimin e pronarëve të ligjshëm dhe kalimin e pronave të tyre në pronësi të ndërtuesve të ndërtimeve pa leje. Ligji nuk rregullon vetë mënyrën e kriteret për shpërblimin e pronarëve privatë të shpronësuar, as vendos rregulla për masën e kompensimit që do t'i jepet pronarit të ligjshëm, por ai, në nenin 15, pika 5, të tij, referon te ligji nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” dhe në këtë kuptim është ky ligji që do të zbatohet në lidhje me kompensimin e pronarëve të ligjshëm të parcelave ndërtimore (*vendimi nr. 35, datë 08.02.2007 i Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret Kolegji konstaton se kërkuesi, me cilësinë e pronarit jo posedues, i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me padinë e rivendikimit, duke kërkuar lirimin dhe dorëzimin e truallit në pronësi të tij, mbi të cilin shtetasit K.P. dhe Q.P. si posedues të paligjshëm kanë bërë një ndërtim pa lejen e organeve kompetente. Në përfundim të gjykimit, gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë, duke vlerësuar se nuk plotësoheshin kushtet e padisë së rivendikimit, ndërsa ajo i është kundërdrejtuar të paditurve,

të cilët nuk ishin posedues të paligjshëm, pasi ata kanë aplikuar për legalizimin e objektit të ndërtuar pa leje në truallin e kërkuarit sipas ligji nr. 9482/2006, objekti i tyre është kualifikuar për legalizim dhe është miratuar edhe kalimi i pronësisë së parcelës ndërtimore me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 805, datë 22.07.2009 “Për kalimin e pronësisë së parcelave ndërtimore, në favor të poseduesve të objekteve informale” (VKM nr. 805/2009). Sipas asaj gjykate, të paditurit humbisnin ligjshmërinë e posedimit të truallit vetëm në rast të moslegalizimit të objektit pa leje, rast në të cilin paditësi (kërkuari) legjitimohej në ngritjen e padisë së rivendikimit. Ndërkohë që në rastin e legalizimit të objektit sipas ligjit nr. 9482/2006, paditësi (kërkuari) kompensohej sipas nenit 15/1 të këtij ligji, për rrjedhojë të paditurit nuk mund të detyroheshin për lirim dhe dorëzimin kërkuarit të truallit të zënë nga objekti.

18. Gjykata e apelit ka shqyrtuar çështjen mbi ankimin e kërkuarit dhe duke gjetur të drejtë zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga gjykata e shkallës së parë, ka lënë në fuqi vendimin e saj, duke vlerësuar se të paditurit nuk legjitimohen pasivisht në këtë gjykim, pasi ata nuk janë posedues të paligjshëm të pronës së paditësit (kërkuarit) për sa kohë objekti pa leje i tyre është përfshirë në procesin e legalizimit sipas ligjit nr. 9482/2006, është kualifikuar për legalizim dhe është miratuar kalimi në pronësi të tyre i parcelës ndërtimore. Sipas asaj gjykate, ligj nr. 9482/2006 njeh dhe pranon kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore mbi të cilën është ndërtuar ndërtimi pa leje në pronësi të poseduesit të këtij ndërtimi pa leje, me qëllimin që të zgjidhet dhe harmonizohet çështja e raporteve truall - ndërtim, pasi në të kundërt do të mbetej një çështje e pazgjidhur në thelbin e saj. Po ashtu, ligji përcakton edhe procedurën e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore, pavarësisht se kujt i përket kjo parcelë, pra edhe nëse ajo është në pronësi të të tretëve, subjekteve private pronare të ligjshme. Së fundi, ky ligj balancon edhe “humbjen e pronësisë” të të tretit pronar të ligjshëm mbi parcelën ndërtimore për shkak të këtij ligji, legalizimit të ndërtimit të bërë mbi këtë parcele ndërtimore me shpërblimin e pronarit të ligjshëm, me qëllim që të mos dëmtohen interesat e subjekteve që përfshihen ose që preken nga ky ligj. Sipas gjykatës së apelit, janë pikërisht rregullimet e posaçme të këtij ligji ato që determinojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes në rastin në gjykim, duke passjellë që kërkitimi i sendit nga pronari të jetë jo i drejtë, në kundërshtim me ligjin e sipërcituar, për rrjedhojë të mos pranohet. Po sipas saj, ndonëse procesi i legalizimit në rastin konkret është pezulluar për shkak të këtij gjykimi deri në zgjidhjen e çështjes nga gjykata, paditësi (kërkuari) do të mund të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga kërkesat e nenit 296 të KC-së vetëm pasi organi kompetent i ngarkuar nga ligji nr. 9482/2006 të shprehet për legalizimin ose jo

të ndërtimit pa leje të të paditurve dhe, për rrjedhojë, kalimin ose jo në pronësi të tyre të parcelës ndërtimore mbi të cilën është ngritur ndërtesa.

19. Vendimi i gjykatës së apelit në vijim i është nënshtruar kontrollit nga Gjykata e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit, me arsyetimin se në të nuk ngrihen shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, duke vlerësuar kështu si të drejtë vendimin e asaj gjykate. Në vendimin e saj Gjykata e Lartë ka konstatuar se gjykatat e faktit kanë respektuar dhe zbatuar drejt ligjin material dhe se vendimet e tyre nuk vijnë në kundërshtim me ndonjë vendim të këtij kolegji ose të Kolegjeve të Bashkuara, ndërkohë që pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave, del jashtë juridiksionit të saj rishikues dhe ekskluzivisht ligjor.

20. Në analizë të vendimmarrjeve të mësipërme, Kolegji vëren se, bazuar në faktet dhe provat e rezultuara gjatë gjykimit, gjykatat e fakti kanë marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuarit lidhur me mungesën e legjitimitetit të tij për të ushtruar padinë e rivendikimit, duke dhënë përgjigje të arsyetuara, bazuar në parashikimet e KC-së, ligjit nr. 9482/2016, si dhe jurisprudencës së Gjykatës. Vendimmarrja e gjykatave më të ulëta është bërë objekt kontrolli edhe në Gjykatën e Lartë, në vendimin e së cilës, edhe pse me arsyetim të kufizuar, janë pasqyruar në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, shkaqet e rekursit, si dhe arsyet se përse ai nuk ishte i suksesshëm. Konkretisht, sipas Gjykatës së Lartë, rekursi nuk përmbushte kërkesat ligjore për pranueshmërinë e tij, prandaj vendimmarrja e gjykatës së apelit ngelej e pacenueshme.

21. Në këtë drejtim, Kolegji sjell në vëmendje se ashtu sikurse kanë arsyetuar gjykatat e faktit, kërkuari nuk gëzon të drejtën e padisë së rivendikimit, pasi ligji nr. 9482/2016 “humbjen e pronësisë” së pronarit të ligjshëm mbi pronën e balancon me shpërblimin e tij, me qëllim që të mos dëmtohen interesat e subjekteve që përfshihen ose që preken nga ky ligj. Pavarësisht se procesi i legalizimit është pezulluar për shkak të gjykimit, kërkuari do të mund të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga kërkesat e nenit 296 të KC-së vetëm pasi organi kompetent i ngarkuar nga ligji nr. 9482/2006 të shprehet për legalizimin ose jo të ndërtimit pa leje.

22. Nisur nga sa më lart, Kolegji vlerëson se gjykatat e faktit kanë analizuar në tërësi provat dhe rrethanat e faktit dhe zbatimi i ligjit prej tyre nuk rezulton të jetë arbitrar, në kuptimin e gabimeve ligjore, kurse arsyetimi i tyre nuk rezulton të jetë formalist, sepse ato u kanë kthyer përgjigje pretendimeve të kërkuarit, duke përmbushur standardet e një vendimi të arsyetuar. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e procesit të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit është haptazi i pabazuar. Gjithashtu, në kushtet kur pretendimet e kërkuarit

për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor janë haptazi të pabazuara, Kolegji vlerëson se edhe pretendimet e tij për cenimin e së drejtës së pronës, si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore që i kanë rrëzuar kërkesëpadinë për lirimin dhe dorëzimin e sendit, janë gjithashtu haptazi të pabazuara.

23. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.